

Vendim nr. 217 datë 31.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 31.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SIMON MOLLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 465, datë 02.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-409, datë 06.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 31, 33, 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 134 pikat 1, shkronja “i” dhe pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a, 72 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kallëzimit të bërë nga kërkuesi dhe vëllai i tij, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (*Prokuroria për Krime të Rënda*) ka regjistruar kallëzimin penal nr. 7/2018 për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP) në ngarkim të shtetasve T.H., B.T., D.A. me funksion gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Durrës. Sipas kallëzuesve, ata janë palë në një proces gjyqësor civil të vënë në lëvizje me një padi të tyre, me objekt anulimin e lejes së ndërtimit nr. 05, datë 13.02.2004, të lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të ish-Komunës Bushat, Shkodër, pushimin e cenimit të pronësisë etj. Po sipas tyre, për këtë leje ndërtimi ata kanë paraqitur edhe një kallëzim penal, për të cilin, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria Shkodër*) ka regjistruar një procedim penal (procedimi penal nr. 1193 i vitit 2015), për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, por në përfundim të hetimit është vendosur pushimi i tij me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kundër vendimit të Prokurorisë Shkodër, vijnë ata, kanë paraqitur ankim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur mospranimin e tij. Ata kanë paraqitur, në vijim, ankim edhe ndaj këtij vendimi, por me vendimin nr. 254, datë 15.11.2017, Gjykata e Apelit Shkodër, e formuar nga gjyqtarët e kallëzuar, të cilët ishin deleguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u bazuar në një dokument që nuk ka qenë pjesë e kallëzimit të tyre, duke dhënë kështu një vendim të kundërligjshëm.

2. Pas regjistrimit të kallëzimit, Prokuroria për Krime të Rënda, duke konsideruar se nuk ishte kompetente për trajtimin e çështjes, ka vendosur dërgimin e akteve Prokurorisë Shkodër. Kjo e fundit, duke mos qenë dakord me këtë vendim, ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, mbi bazën e së cilës, me vendimin nr. 74, datë 01.03.2018 (*vendimi nr. 74/2018*), Prokuroria e Përgjithshme ka përcaktuar si prokurori kompetente Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*Prokuroria Kurbin*).

3. Bazuar në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokuroria Kurbin ka regjistruar kallëzimin penal nr. 135 të vitit 2018 (*kallëzimi penal nr. 135/2018*), për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së në ngarkim të shtetasve T.H., B.T. dhe D.A. Me vendimin e datës 20.03.2018, Prokuroria Kurbin ka vendosur mosfillimin

e procedimit penal, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, në referim të nenit 290 pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kundër këtij vendimi kërkuesi ka bërë ankim.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 1884, datë 24.09.2018, ka vendosur pranimin e ankimit të kërkuetit, urdhërimin e Prokurorisë Kurbin të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga Prokuroria Kurbin.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 465, datë 02.12.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1884, datë 24.09.2018 të gjykatës së rrethit, rrëzimin e ankimit të kërkuetit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë 20.03.2018 të Prokurorisë Kurbin. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-409, datë 06.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 12.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi: (i) i gjithë procesi, që nga data e regjistrimit të kallëzimit penal dhe deri në momentin e përfundimit në Gjykatën e Lartë, ka zgjatur rreth shtatë vjet; (ii) Gjykata e Apelit Tiranë ka gjykuar çështjen pas dy vjetësh dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pas pesë vjetësh, në shkelje të nenin 399/2, pika 1, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8.2. *Së drejtës për hetim efektiv*, pasi vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë nga Prokuroria Kurbin tej afatit ligjor 15-ditor, të parashikuar nga neni 291, pika 1, i KPP-së. Vendimi i Gjykatës së Apelit, për sa i përket këtij afati, është rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë nuk është

shprehur dhe nuk i ka trajtuar pretendimet për mosrespektimin e afatit për marrjen e vendimit të mosfillimit.

8.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në shqyrtimin e ankimit kundër vendimit të gjykatës që ka pranuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e hetimeve të procedimit penal, të filluar me kallëzim të kërkuarit dhe të vëllait të tij, në përbërje të trupit gjykues ka qenë edhe gjyqtari B.T., i cili ka marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje tjetër civile të kërkuarit. Dhënia e vendimeve të mëparshme për të njëjtën çështje duhet të përbënte shkak për heqjen dorë të këtij gjyqtari nga shqyrtimi i ankimit të kërkuarit. Fakti që nuk ka dhënë dorëheqjen, si dhe ka përdorur akte nga gjykime të mëparshme, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë

me shterimin e mjeteve juridike efektive. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë pas dy vjetësh dhe nga Gjykata e Lartë pas një periudhe prej pesë vjetësh që nga data e regjistrimit.

13. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vëren se ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, kanë përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Gjykata ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individ duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës me ankim kushtetues individual, pa paraqitur më parë kërkesë në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë dhe pa shfrytëzuar garancitë e mbrojtjes që, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, ofron juridiksioni i zakonshëm gjyqësor për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim

kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa u përket pretendimeve të tjera, rezulton se ato janë parashtruar nga kërkuesi në formë dhe në substancë në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se për to ai nuk ka mjetet të tjera juridike në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 06.03.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 12.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për hetim efektiv, pasi, sipas tij, vendimi i Prokurorisë Kurbin për mosfillimin e procedimit penal të datës 20.03.2018 është marrë tej afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 291, pika 1, të KPP-së. Po sipas tij, arsyetimi i gjykatës së apelit se ky afat është respektuar është rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave të faktit, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka anashkaluar pretendimet e tij në këtë drejtim.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji evidenton se gjykata e rrethit ka konstatuar se vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë më 20.03.2018, ndërkohë që vendimi nr. 74/2018 i Prokurorisë së Përgjithshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, përmes të cilit aktet e procedimit penal i janë dërguar për kompetencë Prokurorisë Kurbin, është marrë më 01.03.2018. Gjykata e rrethit ka vlerësuar se vendimi i mosfillimit nuk është marrë brenda afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 1, i KPP-së, duke iu referuar për këtë qëllim datës 17.01.2018 kur është bërë kallëzimi penal në raport me shkresën nr. 4352 prot., datë 20.06.2018 të Prokurorisë Kurbin, kur vendimi i mosfillimit u është dërguar ankuesve.

Ndërsa gjykata e apelit ka vlerësuar se konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se vendimi është marrë tej afatit 15-ditor është i pabazuar dhe nuk mund të përbëjë bazë për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit, pasi vendimi nr. 74/2018 i Prokurorisë së Përgjithshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe caktimin e kompetencës së Prokurorisë Kurbin i është përcjellë kësaj të fundit me shkresën nr. 571/1 prot., datë 01.03.2018 të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila është protokolluar në Prokurorinë Kurbin me nr. 1621 prot., datë 05.03.2018. Ndërsa kallëzimi penal është regjistruar nga kjo prokurori në datën 05.03.2018 dhe në datën 20.03.2018, brenda afatit ligjor 15-ditor, të parashikuar nga neni 291, pika 1, i KPP-së, Prokuroria Kurbin ka vendosur mosfillimin e procedimit. Ky vlerësim i gjykatës së apelit është gjetur i bazuar në thelb edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

20. Për sa më lart, referuar argumenteve të kërkuësit për pretendimin e cenimit të së drejtës për hetim efektiv, rezulton se arsyetimi i vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh me të drejtën për proces të rregullt ligjor, në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës. Për më tepër, në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë sesi qëndrimi i gjykatës së apelit dhe i Gjykatës së Lartë për mënyrën e llogaritjes së afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 1, i KPP-së, ka cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të hetimit efektiv. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një paanshme, pasi ankimi i paraqitur në gjykatën e apelit është shqyrtuar nga trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë gjyqtari, B.T., i cili ka shqyrtuar një çështje tjetër civile të tij. Sipas kërkuësit, dhënia e vendimeve të mëparshme përbënte shkak për heqjen dorë të këtij gjyqtari nga shqyrtimi i ankimit.

22. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka

ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (shih vendimet nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

23. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjyqtari B.T., për të cilin kërkuesi ka ngritur pretendime në kuadër të njëanshmërisë së tij në gjykim, nuk ka qenë anëtar i ndonjërit prej trupave gjykues të gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen objekt të ankimit kushtetues individual. Pretendimi i kërkuesit për këtë gjyqtar ngrihet në drejtim të pjesëmarrjes së tij në të tjera procese të nisura nga kërkuesi. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se, për sa kohë që gjyqtari për të cilin kërkuesi ka ngritur pretendime në kuadër të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e paanshme nuk ka shqyrtuar çështjen konkrete të tij, ky pretendim i tij është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.